




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.472/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE NPSH “Bageri”-Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Rahovica Commerce” Sh.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugës Marie Shllaku nga Tranziti në Lipjan deri te Lumi Janjevka”, me numër të prokurimit: 613-20-2234-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK Lipjan, më datën: 20.08.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: NPSH “Bageri”-Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugës Marie Shllaku nga Tranziti në Lipjan deri te Lumi Janjevka”, me numër të prokurimit: 613-20-2234-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK Lipjan.

II.VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugës Marie Shllaku nga Tranziti në Lipjan deri te Lumi Janjevka”, me numër të prokurimit: 613-20-2234-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK Lipjan.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NPSH “Bageri”-Ferizaj, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE: NPSH “Bageri” -Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 16.07.2020 me nr. 472/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Asfaltimi i rrugës Marie Shllaku nga Tranziti në Lipjan deri te Lumi Janjevka”, me numër të prokurimit: 613-20-2234-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59 dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.07.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 03.08.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimin nr.1, Lidhur me pretendimin e parë ankimorë, ku OE ankues është eliminuar për mungesë të finisherit, ku OE ankues pretendon se :

“Sa i perket finisherit ne fatur nuk shkruan vetem finisher per shtrimin e asfaltit por ne atefature jan edhe marka dhe lloji ifinisherit siq eshte Fertiger DF45C ku me nje klikim ne Google keni mundur ta verifikoni se qfar finisheri eshte ky por pasi qe ju nuk e keni bere te njejten do ua bashkangjes me ankese dhe ta shifni qe i njejti eshte siq eshte kerkuar.”.

Sqarojmë se sipas dosjes së tenderit , kërkesa numër 3 pika “e” është kërkuar :

“e. Finisher per shtrirje te asfaltit min 1 cope”.

Ndërsa po në kërkesën nr.3 pika “f” është kërkuar :

“f.Finisher per shtrirje te Asfaltit ne trotuar min 1 cope”.

Siç mund të shihet nga dosja e tenderit kërkesa nr.3 pika “e” dhe pika “f”, AK ka kërkuar dy finisher, ndërsa OE ka ofruar dëshmi vetëm për një fisniher për të cilin pretendon se është për trotuare.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është vetëm pjesërisht i bazuar, dhe nëse marrim për bazë pretendimin e OE ankues se injëti e plotëson pikën “F” nga kërkesa nr.3, atëher OE ankues nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit nr.3 pika “E”, dhe anasjelltas.

Përgjigje në pretendimin nr.2, Lidhur me pretendimin e dytë ankimorë AK në arsyetim të ekërkersës për rishqyrtim thotë :

“Sqarim:Kerkese e AK ka qene pika i) Burgi Hidraulike per shpim verikalper vendosje te shtyllave min 1 cope) Ju si OE per kete mjet pune keni dorzaur makine per shpim te puseve (Bunareve) dhe nje kamion per shpim, qe te dyja keto mjete jane jashte kerkesave te AK, Zyra e prokurimit dhe komisioni per vlersim te ofertave nuk mund te merr per baze deshmite per mjetet qe i dorzoni qe jane jashte kerkesave te AK. Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar”.

Fillimisht sqarojmë se qëndron konstatimi i AK-së se pajisja e ofruar nga OE ankues, sipas dudit doganor shënon “*Makineri e përdorur për shpimin e pueseve, Marka CMV, Tpi :MK-2000M e qmontuar (me zhingjir)...*”.

Me gjithë se kjo pajisje për nga emërtimi nuk është “Burg Hidraulike për shpim verikal për vendosje të shtyllave”, dhe është pajisje më e madhe se pajisja e kërkuar nga AK, konsiderojmë se e njëjta në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesën e AK-së sepse e njëjta mund të kryej shpimin vertikal/hapjen e vrimave për bazament/vendosje të shtyllave.

Bazuar në sqarimet e shënuara më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 04.08.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik nuk është përgjigjur në ekspertizën e ekspertit shqyrtues edhe pse është njoftuar me raportin e ekspertizës nga OSHP.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 20.08.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e parë ankimor, që sipas AK-së OE ankues është eliminuar për mungesë të finisherit, ndërkaq OE ankues pretendon se: “Sa i perket finisherit ne faturë nuk shkruan vetëm finisher për shtrimin e asfaltit por ne ate fature janë edhe marka dhe lloji i finisherit sic eshte Fertiger DF45C ku me nje klikim ne Google keni mundur ta verifikoni se çfarë finisheri eshte ky por pasi qe ju nuk e keni bere te njejten do ua bashkangjes me ankese dhe ta shifni qe i njehti eshte siç eshte kerkuar”.

Paneli shqyrtues pasi që shqyrtoj pretendimin ankimor sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit nr. 3 pika “e” është kërkuar: “e. *Finisher per shtrirje te asfaltit min 1 cope*”, ndërsa po në kërkesën nr. 3 pika “f” është kërkuar: “f. *Finisher per shtrirje te asfaltit ne trotuar min 1 cope*”.

Paneli shqyrtues sqaron se nga dosja e ofruar nga OE ankues dhe kërkesa e AK-së mund të shihet se në kërkesën nr.3 pika “e” dhe pika “f”, AK ka kërkuar dy finisher, ndërsa OE ka ofruar dëshmi vetëm për një finisher për të cilin pretendon se është për trotuare, andaj paneli shqyrtues e vlerëson si pjesërisht të bazuar pretendimin ankimor sepse i njëjti plotëson pikën “f” të kërkesës numër 3 të dosjes së tenderit “finisher për shtrirje të asfaltit në trotuare” mirëpo nuk plotëson pikën “e” të kërkesës numër 3 të dosjes së tenderit “finisher për shtrirje të asfaltit”.

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor, ku AK në arsyetim e kërkesës për rishqyrtim thotë: “*Sqarim: Kerkese e AK ka qene pika i) Burgi Hidraulike për shpim verikalper vendosje te shtyllave min 1 cope*) ju si OE per kete mjet pune keni dorzaur makine per shpim te puseve (Bunareve) dhe nje kamion per shpim, qe te dyja keto mjete jane jashte kërkesave te AK, Zyra e prokurimit dhe komisioni per vlersim te ofertave nuk

mund te merr per baze deshmite per mjetet qe i dorzoni qe jane jashte kerkesave te AK. Ky pretendim i juaji eshte i pabazuar”.

Paneli shqyrtues sqaron se konstatimi i AK-së se pajisja e ofruar nga OE ankues, sipas dudit doganor shënon “Makineri e përdorur për shpimin e pucseve, Marka CMV, Tpi :MK-2000M e qmontuar (me zhingjir)...”. Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues vlerëson se megjithëse kjo pajisje për nga emërtimi nuk është “Burgi Hidraulike per shpim verikal per vendosje te shtyllave”, dhe është pajisje më e madhe se paisja e kërkuar nga AK, konsiderohet se e njëjta në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesën e AK-së sepse e njëjta mund të kryej shpimin vertikal/hapjen e vrimave për bazament/vendosje të shtyllave, andaj paneli shqyrtues e vlerëson pretendimin ankimor si të bazuar.

Paneli shqyrtues pasi që shqyrtoj dhe analizoj pretendimet e OE ankues vlerëson se autoriteti kontraktues në këtë procedurë të prokurimit në përgjithësi i ka respektuar dispozitat e LPP-së dhe ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së. OE ankues nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit nr. 3 më saktësisht pikën “e” të kësaj kërkeje andaj autoriteti kontraktues të njëjtin e ka shpallur të papërgjegjshëm.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK- “KK Lipjan”

1x1 OE -NPSH“Bageri”-Ferizaj

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.